

POLITIKA MONETARE : NJË VËSHTRIM
ANALITIK MBI TË KALUARËN DHE TË
ARDHMEN

Shkëlqim Cani
Guvernator i Bankës së Shqipërisë

EKONOMIA SHQIPTARE NË DEKADËN E KALUAR.

FUNDI I VITEVE '80 , VITET E RËNIMIT EKONOMIK.

Përvjetori i antarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore pak a shumë përkon dhe me vendimet e para politike të ndërmarra nga autoritetet shqiptare në drejtim të vënies nën kontroll të treguesve kryesorë të ekonomisë, të cilët në kohën të cilës po i referohemi ishin të shpërfytyruar.

Ashtu sikurse shumë nga të pranishmit në sallë mund të jenë dëshmitarë, si pasojë e centralizimit ekstremist dhe mbështetjes në vetvete, për dekada të tëra Shqipëria u shkëput nga vendet e tjera të Europës, madje edhe nga ato të Europës Qendrore dhe Lindore. Si rrjedhojë, Shqipëria u gjend tërësisht e papërgatitur për të kaluar në ekonominë e tregut, gjë që çoi në shkatërrimin e ekonomisë në pjesën më të madhe të saj dhe në rënien e nivelit të jetesës në mënyrë të ndjeshme.

Në këtë situatë, Shqipëria u përfshi në një krizë të thellë ekonomike dhe financiare. Vitet 1985-1992 ishin vitet e një rënieje të shpejtë dhe të theksuar të prodhimit, të zbalancimeve të mëdha makroekonomike, të brendshme e të jashtme, të një çrregullimi të përgjithshëm në drejtim dhe në infrastrukturë, të shkatërrimit të rezervave valutore si dhe të krijimit të borxhit të jashtëm të vendit. Në vitin 1989 prodhimi i përgjithshëm i vendit ishte përgjysmuar, ndërkohë që si prodhimi industrial dhe ai bujqësor pësuan rënie të theksuar.

Prodhimi i drithërave u ul në një të dytën e prodhimit të viteve 1980. Kështu, Shqipëria nga një vend eksportues i prodhimeve bujqësore e blegtorale u kthye në një vend që, në shkallë shumë të lartë, varej nga ndihmat kritike dhe urgjente nga jashtë. Efektet e kësaj situatë u pasqyruan menjëherë në treguesit e papunësisë, të cilët pësuan rritje të ndjeshme veçanërisht në industri.

Si pasojë kjo solli emigrimin e shumë shqiptarëve, kryesisht në vendet fqinje. Gjendja financiare e vendit u keqësua me ritme të shpejta. Kjo u shoqërua me rritje të pagës nominale si dhe të pagesës në formën e asistencës për ndërmarrjet që nuk funksiononin. Të ardhurat nga taksat ranë nga 42 për qind të PBB-së në vitin 1990 në 28 për qind të PBB-së në vitin 1991 dhe ende më tej, në 16 për qind në gjysmën e parë të vitit 1992. Rritja e vazhdueshme e deficitit buxhetor dhe mungesa e një politike monetare të përshtatshme çuan në moskontrollin e likuiditeteve, të inflacionit, të kursimeve dhe në një nivel thellësisht negativ të përqindjes së interesit, në terma realë.

Duke reflektuar gjithë këto probleme, mungesën në furnizim me produkte ushqimore si dhe masat për liberalizimin e çmimeve, gjatë vitit 1990-1991, inflacioni u ngrit ndjeshëm, në mbi 100 për qind duke kaluar rreth 15-20 për qind në muaj gjatë fillimit të vitit 1992. Në situatën kur kursi zyrtar i këmbimit ishte shumë larg nga kursi i këmbimit në tregun paralel, rezervat valutore kishin rënë në mënyrë të ndjeshme dhe bilanci tregtar ishte keqësuar së tepërmi.

Bilanci i pagesave pasqyronte një deficit të ndjeshëm dhe me shumë pasoja për ekonominë.

Tabelë 1. Tregues Kryesorë Makroekonomikë⁵⁴.

	1980-85 1/	1986	1987	1988	1989	1990	1991	1992
PBB 2/	16376	17390	17254	17008	18681	16811	12156	10974
Ndryshimi	2.0	5.6	-0.8	-1.4	9.8	-10.0	-27.7	-9.7
Ndryshimi në Përqindje								
Prodhimi i Përgjithshëm	2.6	5.0	1.5	2.1	5.0	-19.6	-36.9	-60.0
Industrial								
Prodhimi i Përgjithshëm Bujqësor	3.0	4.0	0.5	-6.2	10.6	-4.4	-20.9	18.0
Rritja e Popullsisë	2.1	2.0	2.0	2.0	1.9	1.8	-0.9	-1.1
Rritja e të Punësuarve	3.0	3.3	3.0	1.7	1.9	0.2	-19.2	-17.4
Përqindja e Papunësisë	4.3	5.4	5.2	6.0	6.7	8.5	11.4	23.9
Ndryshimi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	104.1	236.6
Vjetor i IÇK 3/								
Në Përqindje ndaj PBB-së								
Të Ardhurat e Buxhetit	50.9	48.7	49.2	53.2	48.2	47.0	32.0	23.3
Shpenzimet e Buxhetit	53.5	48.8	50.9	54.4	56.8	63.6	64.0	40.7
Bilanci Fiskal	-2.6	-0.1	-1.7	-1.2	-8.6	-16.6	-34.0	-17.4
Ndryshimi në Përqindje								
Kredit i Brendshëm Gjithsej	7.5	3.5	12.8	-0.7	21.5	21.9	80.0	59.0
Paraja Gjithsej (M3)	3.5	7.3	7.2	7.8	14.8	21.0	110.0	152.7
Paraja në Qarkullim	6.6	7.0	12.3	6.2	0.6	36.5	169.0	123.0
Në miliona USD								
Bilanci i Llogarisë Korrente	-27.6	0.5	7.8	-23.5	-70.4	-95.1	-250.0	-31.6
Bilanci Tregtar	-33.2	-0.6	1.0	-34.8	-90.9	-109.6	-209.0	-453.0
Eksportet	116.6	95.5	100.3	106.6	132.7	123.0	72.0	70.0
Importet	149.8	96.1	99.3	141.4	223.6	232.6	281.0	523.0

1/ Mesatare e periudhës.

2/ Me çmime të vitit 1990.

3/ Fundi i periudhës.

⁵⁴ Burimi: "Albania: From Isolation Toward Reform", International Monetary Fund, September 1992 dhe Banka e Shqipërisë.

TERAPITË E PARA DHE "VIRUSI" FAJDE

Kolapsi i përgjithshëm politik – ekonomik i fundvitit 1991, u thellua më tej në gjashtëmujorin e parë të vitit 1992. Megjithatë, zgjedhjet politike të marsit 1992, shënuan një pikë kthese, pasqyrim i së cilës ishte hartimi i një programi emergjence, qëllim kryesor i të cilit ishte, që brenda një periudhe gjashtëmujore (korrik – dhjetor 1992) të frenonte thellimin e mëtejshëm të zbalancimit makroekonomik të vendit. Për herë të parë që nga koha e themelimit të institucioneve të Breton Woods-it, autoritetet shqiptare nënshkruan një marrëveshje mbështetjeje me FMN-në, ku Shqipërisë ju akordua një mbështetje financiare e paraparë në kuadrin e lehtësirave Stand-by.

Terapia intensive e përdorur gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1992, i dha rezultatet e saj të para shumë shpejt duke krijuar një ambient të përshtatshëm makroekonomik, për të ndërmarrë veprime dhe reforma më të thella përgjatë një periudhe afatmesme.

Inflacioni galopant i viteve 1990 – 92 filloi të bjerë, shoqëruar me një stopim të rënies së mëtejshme të prodhimit etj.. Ndërkohë, disa masa të shpejta si heqja dorë nga subvencionimi i mëtejshëm i ndërmarrjeve shtetërore me humbje, liberalizimi i pjesës dërrmuese të çmimeve të konsumit, fillimi i procesit të privatizimit dhe veçanërisht privatizimi i tokës, reforma në administratën e fryrë shtetërore etj., krijuan hapësirat e domosdoshme për ecjen me shpejtësi në rrugën e konsolidimit makroekonomik të vendit sidomos në periudhën që pasoi, 1993 - 1995.

Fundi i vitit 1995 ofronte një tablo optimiste ku spikaste rritja e prodhimit në nivelin 13.4 për qind, niveli njëshifror i inflacionit me vetëm 6 për qind ndërkohë që evidentohet një rritje e rezervave valutore, përmirësim i nivelit të punësimit, stabilitet i monedhës kombëtare, ecuri pozitive e procesit të privatizimit; zhbllokimi i hyrjes së kapitaleve të huaja si rezultat i zgjidhjes së borxhit të jashtëm etj..

Periudha dyvjeçare në vijim, përkon me “lulëzimin” dhe “perëndimin” e firmave piramidale. Përqindjet e larta të interesit të firmave “zëvendësuan” totalisht përqindjen e interesit të ofruar nga sistemi bankar e, **për rrjedhim, efektiviteti i politikës monetare u reduktua ndjeshëm**. Përqindjet e larta çuan në prurje të mëdha depozitash në sportelet e këtyre firmave ndërkohë që investimi i

tyre në prodhim dhe letra me vlerë ishte minimal krahasuar me shumën e mbledhur. Për më tepër u vu re fenomeni i riinvestimit në këto firma jo vetëm të principalit, por edhe të interesave. Pra "virusi" infektoi ekonominë, financat, por edhe mendjet e shqiptarëve. Për t'u pasuruar pa punuar ata shitën deri bagëtinë, shtëpitë dhe kursimet i vendosën në fondacionet mashtruese. Pamundësia e administrimit të depozitave nga ana e firmave piramidale bëri që këto të fundit t'i depozitonin ato në llogari rrjedhëse në bankat tregtare, duke ju krijuar atyre rezerva të tepërta në sasira të mëdha, të cilat shkonin në blerje bonosh thesari. Si përfundim, në fund të vitit 1996, inflacioni rezultoi 3 herë më i lartë nga ai i vitit paraardhës duke reflektuar një rritje të madhe të kredisë për qeverinë nga ana e sistemit bankar. Pasojat e falimentimit të firmave rentiere ishin të gjithanshme dhe, për rrjedhim, ato sollën dhe një faturë të madhe ekonomike. Në fund të vitit 1997, rënia e prodhimit u shoqërua me një përshpejtim të inflacionit, përkeqësim të pozicionit të jashtëm të vendit dhe me shtim të papunësisë. Përpjekjet e bëra nga ana e Bankës së Shqipërisë, për uljen e inflacionit dhe thithjen e parave në banka, duke rritur përqindjen e interesit, në rreth 30 për qind, filluan të jepnin frytin e tyre.

1998 - 2000: RRUGA DREJT KONSOLIDIMIT MAKROEKONOMIK

Ashtu si në mesin e vitit 1992 edhe këtë rradhë, shenjat e para të rivendosjes së kontrollit mbi treguesit e përgjithshëm ekonomikë u evidentuan që në gjysmën e dytë të vitit 1997, gjë që reflektohet në arritjen e rezultateve më të mira se parashikimi i bërë për fundin e vitit. Në të vërtetë, ekonomia shqiptare ju nënshtrua një programi⁵⁵ tjetër emergjence, i cili ashtu si dhe në vitin 1992, njohu mbështetjen e FMN-së, por këtë rradhë marrëveshja u titullua "Për Mbështetjen e Programit të Emergjencës pas Konfliktit".

Rezultatet e politikave të ndërmarra u bënë më të prekshme në fund të vitit 1998. Inflacioni i lartë dyshifror i fundvitit 1997, ra në nivelin 8.7 për qind. Rritja e besimit të publikut dhe investitorëve, e shoqëruar me lehtësimin e disahershëm gjatë vitit të kushteve monetare, ndihmoi në zgjerimin e kërkesës së brendshme. Kjo bëri që prodhimi i brendshëm të rikuperohej në nivelet e tij të parakrizës. Politikat stabilizuese të ndërmarra, të cilat nga vetë natyra e tyre parashikojnë vendosjen e kufizimeve të forta monetare dhe financiare në ekonomi, patën edhe koston e tyre sociale, gjë që reflektohej në rritjen më tej të shkallës së

⁵⁵ Shtator 1997 - mars 1998.

popullsisë dhe në shtrirjen e varfërisë në segmente të gjera të popullsisë. Megjithë pasigurinë që karakterizoi ekonominë shqiptare në fillimet e tragjedisë kosovare gjatë vitit 1999, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, u arrit të evitoheshin në një shkallë të madhe pasojat e saj. Zhvillimet makroekonomike mbetën brenda kuadrit të programuar. Për këtë flasin rritja e mëtejshme ekonomike që njohu ekonomia jonë në masën 8 për qind, dhe rënia e inflacionit në nivele të papara ndonjëherë gjatë gjithë dekadës së fundit. Për herë të parë të ardhurat për frymë të popullsisë vlerësohet të kenë kapërcyer nivelin e 1000 dollarëve amerikanë. Të dyja politikat, si ajo fiskale ashtu edhe ajo monetare, rezultuan në përputhje me angazhimet dhe, për rrjedhim, efektet e tyre kanë pasur ndikim pozitiv në ecurinë e inflacionit. Nga ana tjetër, prurjet e mëdha në mallra dhe në valutë që Shqipëria thithi gjatë vitit 1999, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në kursin e këmbimit, duke kontribuar direkt edhe mbi stabilitetin e çmimeve. Gjithësesi, sfidë për të ardhmen mbetet stabilizimi i tij për periudha më afatgjata.

Tabelë 2. Tregues Kryesorë Makroekonomikë⁵⁶.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
PBB 1/ Ndryshimi	12309 9.6	13331 8.3	15107 13.3	16478 9.1	15325 -7.0	16556 8.0	17880 7.3	19275 7.8
Ndryshimi në Përqindje								
Prodhimi i Përgjithshëm Industrial	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1	6.4	5.0
Prodhimi i Përgjithshëm Bujqësor	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0	5.0	4.5
Rritja e Popullsisë	1.1	1.5	1.1	1.3	0.9	0.6	0.8	0.8
Numri i të Punësuarve	1046.0	1161.0	1138.0	1116.0	1107.0	1103.0	1081	1068.0
Përqindja e Papunësisë	22.3	18.4	13.1	12.4	14.9	17.8	18.0	17.3
Ndryshimi Vjetor i IQK 2/	30.9	15.8	6.0	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2
Në Përqindje ndaj PBB-së								
Të Ardhurat e Buxhetit	26.7	24.1	23.4	18.4	16.6	20.3	21.2	22.4
Shpenzimet e Buxhetit	40.4	33.1	33.6	31.2	29.5	30.7	32.7	31.6
Bilanci Fiskal (Financim i brendshëm)	-9.1	-8.6	-6.5	-10.2	-11.2	-6.6	-5.5	-4.9
Ndryshimi në Përqindje								
Kredit i Brendshëm Gjithsej	352.3	27.4	28.0	48.1	43.0	17.8	10.6	6.5
Paraja Gjithsej (M3)	75.2	40.6	51.8	43.8	28.5	20.7	22.3	12.0
Paraja në Qarkullim	74.3	55.8	49.9	17.7	47.6	-6.4	27.4	22.3
Në miliona USD								
Bilanci i Llogarisë Korrente	18.8	71.4	36.6	-62.3	-253.7	-65.0	-132.9	-163.1
Bilanci Tregtar	-508.9	-459.6	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-821.0
Eksportet	111.6	141.4	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.4
Importet	-620.5	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-
								1076.4

1/ Me çmime të vitit 1990.

2/ Fundi i periudhës.

⁵⁶ Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe INSTAT.

Dy vitet e fundit 2000 - 2001, duket se kanë kontribuar në një konsolidim të mëtjshëm të ekuilibrave të përgjithshëm në ekonomi. Kjo gjë reflektohet në ecurinë, brenda kufijve të programuar gjatë vitit 2000, ndërkohë që besohet se dhe fundi i këtij viti do të regjistrojë vlera të njëjta me ato të programuara. Ndoshta është momenti që të theksohet se vëmendja e autoriteteve tashmë, veç shqetësimit për ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm ekonomik, duhet të synojë drejt një shqetësimi më të madh, që ka të bëjë me realizimin në kohë dhe me çdo kusht të reformave dhe të rregullimeve strukturore të ndërmarra dhe të parapara në programet afatmesme të zhvillimit të vendit. Unë e gjykoj se përdorimi me çdo kusht i këtyre "medikamenteve" me rëndësi jetike do të jetë kyçi themelor i suksesit si për thellimin e mëtjshëm të konsolidimit makroekonomik të vendit ashtu dhe për përmbushjen e angazhimit afatgjatë të Qeverisë për uljen e shkallës së varfërisë në vend.

POLITIKA MONETARE – NJË VËSHTRIM NË DEKADËN E KALUAR

Dy politikat bazë, të cilat në rrjedhën e këtyre 10 viteve kanë ndihmuar në stabilizimin e shpejtë të ekonomisë duke ndikuar më së shumti në zbutjen e presioneve inflacioniste në ekonomi, kanë qenë politika monetare dhe ajo fiskale. Në këtë rrjedhë vitesh ka pasur momente gjatë të cilave dominimi i një politike ka qenë i dukshëm ashtu sikurse ka pasur dhe momente (kjo ka qenë dhe prirja e përgjithshme) gjatë të cilave të dyja politikat janë zhvilluar në harmoni me njëra tjetrën, duke përbërë një faktor jetik në arritjen e suksesit.

Megjithatë sot, 10 vjet më pas mund të thuhet se mësimet e marra gjatë kësaj periudhe të vështirë arritjesh dhe sfidash, imponojnë rëndësinë e përparimit të mëtjshëm, në drejtim të atyre kushteve që çojnë në një pakësim sa më real të kompromentimit të politikës monetare nga vendime dhe objektiva të çastit, të ndërmarrë nga autoritetet fiskale të vendit. Duke gjykuar se ky argument do të gjejë vend përsëri në vazhdimësinë e këtij prezantimi, shpreh besimin e institucionit që unë drejtoj se hapat që do të ndërmerren në këtë drejtim do të jenë konkretë në të ardhmen e afërt dhe atë të mesme.

Për herë të parë politika monetare në Shqipëri u ideua dhe u zbatua në mesin e vitit 1992, kur, si pjesë e marrëveshjes së mbështetjes të FMN-së për Shqipërinë, u prezantuan për herë të parë disa vendime, të cilat synonin vendosjen e kontrollit mbi ofertën e parasë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të

drejtpërdrejta të kontrollit monetar. Që në ligjin e parë të Bankës së Shqipërisë përmendet "ruajtja e vlerës së brendshme dhe të jashtme të monedhës kombëtare"⁵⁷, si rrjedhim i së cilës do të ishte sigurimi i stabilitetit të çmimeve të konsumit.

Në rrjedhën e viteve objektiv i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë u rafinua më tej, duke tentuar gjithnjë e më shumë drejt një përcaktimi të qartë të stabilitetit të çmimeve si objektiv final të politikës monetare. Më konkretisht, në ligjin në fuqi që rregullon aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, citohet se "arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve"⁵⁸, është objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë ndërkohë që të gjithë objektivat e tjerë rrjedhin prej këtij objektiv.

Në këtë mënyrë, duket se Banka e Shqipërisë e ka zgjedhur prej kohësh dilemën e përzgjedhjes së objektivit themelor të politikës monetare, në favor të stabilitetit të çmimeve duke besuar se me anë të kësaj zgjedhjeje i shërben, në mënyrën më të mirë të mundshme dhe rritjes së prodhimit, të punëzënies etj., në afat të gjatë.

Duke ju kthyer edhe një herë vitit 1992, si objektiv i ndërmjetëm u zgjedh baza monetare, ndërkohë që si instrumente bazë për kontrollin monetar do të ishin dy: kufiri i kredisë dhe vendosja në mënyrë administrative e përqindjes⁵⁹ së interesit për depozitat me afat në lekë të vendosura në bankat me kapital shtetëror⁶⁰. Që nga korriku i vitit 1992 (vazhdon akoma dhe në ditët e sotme) u adoptua një regjim "luhatje e lirë" e kursit të këmbimit ndërkohë që, transaksionet në llogarinë korente u liberalizuan plotësisht.

Siç mund të merret me mend, që nga viti 1992 e në vazhdim, Banka e Shqipërisë, zgjedhi një regjim të pastër të përcaktimit të objektivave për paranë, duke qëndruar vazhdimisht larg përzgjedhjes së një regjimi të përcaktimit të objektivave për kursin e këmbimit, ndërkohë që në asnjë rast nuk është marrë në konsideratë adoptimi i një regjimi monetar *currency board*.

Ndër veprimet e para, të adoptuara nga politika monetare do të veçonim rritjen e menjëhershme të përqindjes së interesit për depozitat në lekë të vendosura në bankat me kapital shtetëror nga

⁵⁷ Ligji nr. 7559, datë 22.4.1992, " Për Bankën e Shqipërisë" , neni 3, paragrafi 1.

⁵⁸ Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, " Për Bankën e Shqipërisë" , neni 3, pika 1.


⁵⁹ Niveli i minimal i tyre.

⁶⁰ Në vitin 1992 e për disa vjet me rradhë, sistemi bankar në Shqipëri përbëhej vetëm nga banka me kapital shtetëror.

2 – 3 pikë përqindjeje⁶¹ para korrikut '92, në 28 pikë përqindjeje ndërkohë që të gjitha bankat pa përjashtim, ju nënshtruan kufizimeve sasiore në rritjen e tepricës së kredisë.

Gjendja kritike, në të cilën ndodheshin rezervat valutore të vendit nuk lejonte një pjesëmarrje aktive të Bankës së Shqipërisë në treg dhe, për më tepër, aplikimi i një kursi këmbimi lirisht të luhatshëm gjykohej se do të shërbente si një rregullator automatik i pozicionit të përgjithshëm të bilancit të pagesave, në një kohë që dollarizimi i ekonomisë ishte në shkallë të lartë.

Në mungesë të alternativave⁶² të tjera u vendos që financimi i deficitit buxhetor me burime të brendshme të bëhej në masën 100 për qind me kredi të drejtpërdrejtë të Bankës së Shqipërisë, fenomen, i cili ndonëse në formë tjetër dhe madhësi shumë më të



Grafiku 1. Oferta e Parasë
(Ndryshimi vjetor në përqindje; Fundi i periudhës)

vogël, është i pranishëm dhe në ditët e sotme.

Korniza e mësipërme e politikës monetare të zbatuar në mesin e vitit 1992, mbeti pothuajse e pandryshuar për një periudhë trevjeçare. Duhet theksuar se megjithëse në dukje ajo ishte relativisht e thjeshtë, duke e zhvendosur në kontekstin e asaj kohe,


⁶¹ Me bazë vjetore.

⁶² Për herë të parë bonot e thesarit u përdorën për financimin e deficitit buxhetor në majin e vitit 1995.

kuptohet që zbatim i saj në praktikë haste në vështirësi të shumta, të cilat nga njëra anë pasqyronin shkallën e ulët të perceptimit dhe të zbatimit në praktikë nga vetë Banka e Shqipërisë, dhe nga ana tjetër një nivel të ulët asimilimi dhe përgjegjshmërie të bankave të nivelit të dytë. Me rëndësi është fakti se kjo periudhë regjistroi një harmonizim të kënaqshëm midis të dyja politikave bazë (asaj monetare me atë fiskale), duke eliminuar në maksimum dhe mundësitë për një kompromentim të mundshëm të politikës monetare nga ajo fiskale.

Po t'i referohemi gjuhës së shifrave, periudha 1993 – 1994, pasqyroi një stopim të admiru-eshëm të hemoragjisë së parasë në qarkullim, arritje e cila para së gjithash reflektonte nivelin e lartë të interesave për depozitat si dhe përpjekjet e mëdha të Bankës së Shqipërisë për t'u imponuar bankave respektimin e kufijve të kreditit. Më ko-nkretisht, në fund të vitit 1994, paraja gjithsej u rrit 41 për qind në bazë vjetore krahasuar me 74.4 për qind që ishte në fund të vitit 1993 dhe 153 për qind në fund të vitit 1992. Këto arritje u reflektuan dhe në ecurinë e inflacionit, i cili në fund të vitit 1994 ishte rreth 15.8 ose 15 herë më i ulët se fundi i vitit 1992.

Ndonëse në fund të vitit 1995 inflacioni regjistroi vetëm 6 për qind në nivel vjetor, zhvillimet e regjistruara në fund të tij, ishin si të thuash sinjalet e para për ngjarjet që pasuan në vitin 1997. Mesi i vitit 1995 përkon me shenjat e para të investimit të parave në skemat piramidale, dhe të mos harrojmë që për një periudhë gati dyvjeçare normat e interesit për depozitat në lekë ishin në rënie të vazhdueshme. Rrjedhojat e pritshme ishin dhe rezultuan të sakta në një ndryshim të tendencës së lëvizjes së ofertës së parasë, e cila duke filluar nga muaji prill i vitit 1995 filloi të rritej përsëri me ritme më të larta se më parë (shih grafikun 1. Oferta e parasë dhe qarkullim: 1992 – 2000).



**Grafiku 2. Deficiti Buxhetor
(Në përqindje ndaj PBB-së)**

Premisat e krijuara që nga viti 1995, u forcuan tepër gjatë vitit 1996, duke u shndërruar në faktorë përcaktues “vendimmarrës” përse i takon zhvillimit ekonomik të vendit dhe perspektivave afatshkurtra të tij. Interesat e ofruara nga tregu joformal i huamarrjes “nxorën totalisht jashtë loje” ato të ofruara nga sistemi bankar e, për rrjedhim, politika monetare u bë inekzistente. Duke mos mjaftuar vetëm kjo, viti 1996 ishte i pasur dhe me zhvillime politike (dy fushata elektorale), të cilat në një mënyrë ose në një tjetër ndikuan në rritjen e shpenzimeve buxhetore, financimi i të cilave do të kompromentonte rëndë arritjen e objektivave finalë për inflacionin (shih grafiku 2. Deficiti buxhetor: 1992 – 2000). Muaji i fundit i vitit 1996, me pak fjalë, konturoi tiparet themelore të atij tërmeti ekonomiko-politik që pasoi në muajt në vazhdim.

E shohim të tepërt të riprodhojmë edhe një herë atë çka përjetoj vendi në muajt e parë të vitit 1997. Një mori e tërë arsyesh, kokëfortësish e mllfesh, inicuan një katrahurë të paparë, rezultat i të cilës ishte kolapsi i plotë ekonomik, politik dhe financiar i vendit. Pa dyshim, gjoba më e kushtueshme edhe në këtë rast i takoi ekonomisë, e cila edhe para këtij kolapsi ishte shumë e brishtë. Pasojat e vitit 1997 ishin të gjithanshme duke filluar që nga shkatërrimi i kapaciteteve prodhuese (PBB në terma realë ra me 7.3 për qind) e deri tek rikthimi tek normat galopante të inflacionit, i cili në muajin dhjetor 1997 arriti kulmin me 42.1 për qind.

Megjithatë, goditjet që mori Banka e Shqipërisë dhe politika monetare që ajo zbaton ishin më të mëdha dhe ato kishin të bënin me:

- humbjen e besimit publik në sistemin bankar, gjë që çoi në një hemoragji të pandalshme të parasë, ndërkohë që rënia e depozitave pa afat dhe në valutë ishte e pashmangshme;
- kompromentimin e politikës monetare nga inekzistenca e financave publike. Mbulimi i deficitit buxhetor me likuiditete të ofruara nga Banka e Shqipërisë, rriti ndjeshëm bazën monetare, duke u bërë në këtë mënyrë një burim i sigurt inflacioni;
- rënien e ndjeshme të besimit ndaj monedhës kombëtare, e cila në mesin e vitit 1997 kishte humbur më shumë së gjysmën e vlerës së saj.

E gjendur para një situatë të tillë, Banka e Shqipërisë ishte e detyruar të reagoonte më vendosmëri në drejtim të rritjes⁶³ së menjëhershme të normës së interesit⁶⁴, i cili në fund të muajit maj 1997 arriti normën më të lartë 28.9 për qind. Ishte ky një nga faktorët bazë, i cili ndikoi që rezultatet e fundvitit 1997 të ishin më të mira nga ato të pritshme. Riparimi i efekteve negative të krizës së vitit 1997, sidomos i atyre afatshkurtra, vazhdoi të kryhej me shpejtësi gjatë vitit 1998 e sidomos në periudhën në vijim. Inflacioni në fund të vitit 1998 ishte vetëm 8.7 për qind, ndërkohë që edhe rekuperimi i prodhimit të përgjithshëm ishte impresionues në nivelin 8 për qind.

Periudha 1999 - 2000, regjistroi përqindje të pazakonta inflacioni për një ekonomi si ajo e Shqipërisë. Edhe pse gjatë vitit 1999 Shqipëria u detyrua të përballonte shpërnguljen biblike të popullsisë së Kosovës, përsëri për shumë arsye të shpjeguara dhe më parë, inflacioni mbeti në kuota të ulëta. Duke filluar që nga ajo kohë e deri në fund të vitit 2000, përqindja e interesit është ulur në mënyrë të vazhdueshme, por, megjithatë, në terma realë ajo ka mbetur shumë e lartë. Nga ana tjetër, reagimi i tregut nuk ka qenë i menjëhershëm dhe kjo, përveç të tjerash, reflektohet edhe në diferencën e lartë që ka ekzistuar midis përqindjes minimale të interesit për depozitat me përqindjen e *yield*-it të bonove të thesarit. Në këto kushte, duke parë të arsyeshëm eliminimin e

⁶³ Në të vërtetë Banka e Shqipërisë filloi rritjet e interesit që nga mesi i vitit 1996, por që fatkeqësisht rezultuan të paefekshme pasi në tregun e fajdesë ofroheshin përqindje pothuajse të njëjta por me bazë mujore.

⁶⁴ Norma e ponderuar e përqindjes së interesit për depozitat e reja në lekë të vendosura në sistemin bankar.

kufijve të poshtëm për depozitat me afat në lekë për bankat me kapital shtetëror, Banka e Shqipërisë synoi të shkelë një rrugë të re, atë të kontrollit monetar nëpërmjet tregut.

POLITIKA MONETARE: VEÇORI DHE ASPEKTE TË TJERA TË SAJ

Nëpërmjet dy paraqitjeve të mësipërme u përpoqëm të kujtonim ose të risillnim edhe një herë para këtij auditori ato që me të drejtë mund të quhen arritjet dhe dështimet e politikës ekonomike dhe të asaj monetare, pak më në veçanti, në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit.

Megjithatë, duke u ndalur te kjo e fundit, do të theksoja se lloji i politikës monetare dhe analizimi i vendimeve të saj është një proces i tërë në të cilin përfshihen ana institucionale, zhvillimi i tregjeve, ambienti i përgjithshëm politik, social dhe ekonomik, aftësitë profesionale etj.. Për të bërë një analizë të plotë dhe që mendoj se do t'i shërbente dhe perspektivës së trajtimit të këtij problemi do të ishte mirë që ky proces të analizohej në të gjithë përbërësit e tij.

Fillimisht do të doja të nënvizoja plotësimin e disa parakushteve të domosdoshme, të cilat me të drejtë konsiderohen si faktorë kyç në arritjen e suksesit.


SHTYLLA INSTITUCIONALE E POLITIKËS MONETARE

Politika monetare është e qartë për të gjithë ne që i delegohet bankave qendrore sepse në afat të gjatë nuk ka konflikt midis objektivit për qëndrueshmëri çmimesh nga njëra anë dhe rritjes ekonomike dhe të punësimit nga ana tjetër. Delegimi tek banka qendrore nënkupton që: politika monetare të ketë sukses duhet të mbështetet edhe nga pikëpamja institucionale. Me fjalë të tjera politika monetare duhet të jetë atribut i një institucioni të pavarur, të përgjegjshëm dhe transparent. Këto tre elemente përbëjnë pika mbështetëse të rëndësishme për një politikë monetare realiste dhe që siguron përfitime të konsiderueshme për vendin në periudhë afatgjatë, pavarësisht se në periudhë afatshkurtër mund të bjerë ndesh me interesa politikë. Ky mësim teorik është i vërtetë edhe në rastin e Shqipërisë. Madje ne jemi akoma më të vetëdijshëm për rolin e madh që ka autoriteti monetar në ushtrimin e presionit të duhur sa herë që ka përpjekje apo prirje për sakrificim të interesave afatgjatë. Banka e Shqipërisë, me një traditë jo të gjatë dhe me origjinë nga një bankë shtetërore tërësisht nën varësinë e Ministrisë së Financave, pati në fillimet e saj një detyrë shumë të

rëndësishme: krijimin e imazhit të bankës qendrore dhe të besueshmërisë të saj. Për të kuptuar se sa e vështirë ishte kjo detyrë, mjafton të për-mend që Banka e Shqipërisë kishte nevojë të bënte të njohur emrin e saj fillimisht në publik. Nga ana tjetër, brenda institucionit të bankës qendrore u krijua një traditë shumë e mirë, ajo e ruajtjes së çdo vlere të krijuar vit pas viti dhe shtimin mbi këtë bazë të vlerave të reja. Kjo ka çuar në konsolidim të strukturës së bankës qendrore dhe të institucionit. Pikërisht kjo arritje krijoi mundësinë dhe kushtet për të folur sot për më shumë pavarësi, përgjegjshmëri dhe transparencë. Të tri këto elemente, në mendjen e çdo punonjësi të bankës qendrore ndihmojnë për të përmbushur më së miri detyrën kryesore tonën: arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një politike monetare realiste dhe të matur.

SHTYLLA E PARË – PAVARËSIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Pavarësia për një bankë qendrore i krijon asaj hapësirën të ndjekë objektivin e përcaktuar në ligj duke qenë e lirë nga presionet politike dhe prirja nga interesat e ditës. Për këtë arsye, arritja e një shkalle të lartë pavarësie për Bankën e Shqipërisë është konsideruar si një domosdoshmëri për të patur rezultate në politikën monetare që zbatohet. Si për çdo bankë tjetër, edhe për Bankën e Shqipërisë do të flisja për dy përmasa të pavarësisë: pavarësinë ligjore dhe pavarësinë reale të saj. Pa dashur të trajtoj elementet e pavarësisë në detaje, më duhet të theksoj disa fakte:



Grafiku 3. Indeksi i Pavarësisë & Inflacioni
(Viti 1996; Inflacioni fundi i periudhës)

- Ligji i bankës qendrore ofron një pavarësi të lartë për Bankën e Shqipërisë pasi ky ligj është hartuar duke patur parasysh standardet ndërkombëtare. Kjo përbën një përparësi, sepse do të thotë që ekziston baza ligjore mbi të cilën mund të ngrihet një institucion i pavarur si dhe hapësirat që ky institucion të funksionojë realisht si i pavarur. Përveç kësaj, përmirësimet e bëra në ligjin e bankës qendrore në këtë dhjetëvjeçar kanë çuar në forcim të pavarësisë ligjore të saj.
- Pavarësia reale e bankës qendrore është mjaft më e ulët se pavarësia ligjore e saj. Kjo ka të bëjë së pari me traditën e varfër institucionale në Shqipëri dhe të respektimit të autoritetit të institucioneve si dhe me traditën “e pasur” në sens negativ për moszbatimin e ligjeve.
- Një sërë faktorësh të tjerë, të cilët janë të pranishëm në mjedisin shqiptar pavarësisht nga përpjekjet e bankës qendrore kanë vepruar, në të shumtën e rasteve, në dëm të forcimit të pavarësisë reale të bankës qendrore. Këta faktorë do t'i grupoja në aspekte të mentalitetit dhe të traditës së vendit dhe në aspekte financiare dhe ekonomike. Në grupin e parë, fillimisht, do të përmendja paqëndrueshmërinë politike në Shqipëri (në këtë dekadë e shprehur me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme dy herë) e cila ka qenë një faktor që nuk ka ndihmuar në forcimin e pavarësisë së bankës pasi nuk janë respektuar të drejtat e këtij institucioni. Për më tepër, banka është detyruar që në periudha acarimesh politike “të heshtë” për të mos u kthyer në një lodër në duar të politikanëve apo është ndodhur në qendër të debateve politike për çështje që kanë nisur nga aspekte të jetës financiare vetëm për të përmbushur disa interesa politikë të çastit. Kësaj sjelljeje joracionale të politikës do t'i shtoja dhe mungesën e opozitës së publikut shqiptar ndaj inflacionit. Me këtë nuk dua të them që publiku shqiptar të kundërshtojë inflacionin njësoj si publiku gjerman, megjithatë, është mjaft e vështirë të gesh përkrahjen sa herë që ngrihet zëri kundër rritjes së çmimeve. Duket se protestën e publikut shqiptar e orientojnë të tjera ngjarje. Nga ana tjetër, mungesa e iniciativës ligjore dhe vetëpërmbytja e institucionit duke patur mungesë komunikimi me publikun për vite të tëra e gërryejnë pavarësinë reale të saj. Në grupin e dytë, do të përfshija shkallën e ulët të zhvillimit të tregut financiar. Ky treg në Shqipëri është i dominuar nga bankat, të cilat gjithashtu, për shkaqe që nuk janë temë e diskutimit të këtij materiali realizojnë një shkallë të ulët ndërmjetësi duke reduktuar rëndësinë e autoritetit të bankës qendrore dhe duke i

dhënë më pak mbështetje pavarësisë së saj. Mjafton të vëmë në raport kreditimin e sistemit bankar për qeverinë me sektorin privat. Gjatë gjithë dhjetëvjeçarit ky raport mesatarisht ka qenë në nivelin 80 – 90 për qind kredi për buxhetin. Pra, banka qendrore, përgjithësisht, ka qenë në pozitë e “rehatimit” të deficitit buxhetor. **Nga ana tjetër, borxhi i brendshëm⁶⁵ arrin nivelet 41.5 për qind të PBB-së.** Ky borxh detyrimisht akomodohet nga banka qendrore dhe bankat e tjera në mungesë të tregjeve të kapitalit. Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë për të realizuar bashkërendimin e politikës monetare me atë ekonomiko – financiare është ende e detyruar të kreditojë drejtpërdrejt qeverinë. Banka e Kursimeve, si e vetmja bankë shtetërore ka një pozicion “gjysmëfiskal”. Duke ditur dhe peshën e saj në tregun bankar, mund të thuhet që banka qendrore i ka mjaft të kufizuara mundësitë për të vepruar me pavarësi në zbatimin e politikës monetare. Këtë e konfirmon më së miri një faktor tjetër, operacionet në tregun e hapur, të cilat në të shumtën e rasteve janë operacione Bankë Shqipërie-Bankë Kursimesh dhe reagimi nuk është realisht reagim tregu.


SHTYLLA E DYTË – PËRGJEGJSHMËRIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Kuptohet, që në një mjedis ku nuk është e qartë se ç’është banka qendrore dhe cilat janë detyrat e saj, pavarësia reale e saj nuk mund të respektohet që në fillim. Për të siguruar këtë banka qendrore ka nevojë të jetë e besueshme në publik. Besimi sigurohet nëpërmjet realizimit të objektivit kryesor. Në këta dhjetë vjet, inflacioni është arritur të mbahet nën kontroll, dhe me përjashtim të disa rasteve të shkëputura, përgjithësisht ai ka qenë në nivele të ulëta. Kjo ecuri inflacioni sigurisht që ka ndikuar në rritjen e besueshmërisë të bankës qendrore.

Megjithatë, duke qenë se në vendet në tranzicion ekonomia është e ekspozuar ndaj *shock*-eve dhe ndryshimeve strukturore si dhe liberalizimit, inflacioni ndikohet ndjeshëm edhe nga faktorë të tjerë, përveç të qenurit fenomen monetar. Për të qartësuar misionin, detyrat dhe instrumentet në dispozicion si edhe efikasitetin me të cilin banka qendrore i ka përdorur ato, Banka e Shqipërisë ka përcaktuar si shtyllë të dytë në rritjen e suksesit të politikës monetare, rritjen e përgjegjshmërisë së saj nëpërmjet përmirësimit të procesit llogaridhënës.

⁶⁵ Memorandumi mbi politikën ekonomike dhe financiare të Republikës së Shqipërisë për 2002 që do të ndërmerren në kuadrin e marrëveshjes trevjeçare “Për reduktimin e varfërisë dhe lehtësimin e rritjes”.

Megjithatë, për të arritur deri këtu u kalua një dekadë ku më shumë mbizotëronte mbyllja e institucionit dhe mbajtja e një distance të dukshme me median. Për të fituar më shumë pavarësi na duhet të lejojmë të tjerët që të vlerësojnë punën e bankës qendrore. Edhe në këtë aspekt do të përqendrohesh në dy përmasa të përgjegjshmërisë së bankës qendrore: përgjegjshmërinë ligjore dhe përgjegjshmërinë reale të saj. Ashtu si pavarësia ligjore edhe përgjegjshmëria ligjore e Bankës së Shqipërisë është relativisht e lartë. Nëse i referohemi treguesit për matjen e përgjegjshmërisë ligjore të ndërtuar nga Haan et Al⁶⁶, vlera e tij në rastin e Bankës së Shqipërisë është 9 nga 13 të mundshmet. Madje nga kjo pikëpamje Banka qendrore e Shqipërisë ruan një vend të respektuar në ra-port me bankat e studjuara nga këta autorë (shih grafiku 4.



Grafiku 4. Matja e Përgjegjshmërisë
Fundi i viteve '90)

Matja e përgjegjshmërisë). Por, përgjegjshmëria ligjore dhe përgjegjshmëria reale kanë diferenca midis tyre. Ashtu si pavarësia reale është mjaft më e ulët se pavarësia ligjore, edhe në këtë rast, përgjegjshmëria reale është më e ulët se ajo ligjore. Rritja e përgjegjshmërisë reale është një proces që kërkon kohë, më tepër emancipim si në vetë punonjësit dhe në drejtuesit e Bankës së

⁶⁶ "Accountability of central banks: aspects and quantification", Jakob de Haan, Fabian Amtenbrink, Sylvester C. W. Eijffinger, Quarterly Review, Banca Nazionale del Lavoro, nr. 209, June 1999, volume LII, fq. 169-194.

Shqipërisë, ashtu edhe në mjedisin, të cilit i drejtohet apo ku raporton Banka. Mangësitë kryesore në të qenurit i përgjegjshëm kanë të bëjnë më cilësinë e raportimit dhe të shpjegimit të veprimtarisë së Bankës si dhe me shkallën e transparencës së saj.

SHTYLLA E TRETË – TRANSPARENCA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Cilësia e të qenurit transparent, gjithashtu, i ka munguar bankës qendrore duke ndikuar në këtë mënyrë në një mbështetje të dobët për pavarësinë reale të saj dhe në marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur. Por, nga ana tjetër, niveli i ulët i transparencës ka ndikuar edhe në mospërfundimin e plotë të politikës monetare. Duke qenë transparente, politika monetare bëhet më e parashikueshme dhe rritet për pasojë eficienta dhe ndikimi i saj në ekonomi. Në të kundërt, as nuk mund të kuptohet se ç'kërkon të arrijë banka qendrore. Transparenca është gjykuar se siguron transmetimin e opinionit dhe të mendimeve të Bankës së Shqipërisë në publik duke bërë të mundur, në këtë mënyrë, një të kuptuar më të mirë të çështjeve të politikës monetare dhe duke përmirësuar reagimin e lojtarëve ekonomikë. Nga kjo pikëpamje, transparenca është trajtuar në dy këndvështrime: si mjet komunikimi dhe si mjet edukimi. Transparenca në shkallë të lartë e zbatuar në një mjedis të paedukuar apo të pafamiljarizuar me çështje të natyrës ekonomike dhe financiare mund të kthehet si një bumerang ndaj vetë institucionit. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë paralelisht ka ndërmarrë një program edukimi, sidomos me mediat, me qëllim që të sigurojë përfitimet maksimale të mundshme të transparencës.

Në tërësi, transparenca në Bankën e Shqipërisë lidhet me:

- shpjegimin e objektivit kryesor të saj dhe të detyrave të tjera;
- shpjegimin dhe deklarimin e objektivave sasiorë, nivelin e realizimit të tyre dhe faktorët që kanë ndikuar;
- shpjegimin e instrumentit të përdorur për të zbatuar politikën monetare;
- shpjegimin e pikëpamjeve mbi normën e interesit dhe si ndryshon ajo në funksion të faktorëve të caktuar;
- shpjegimin e çdo kuadri ligjor e rregullator në funksion dhe që mbështet zbatimin e politikës monetare në mënyrë të pavarur.

TREGJE FINANCIARE

Efektiviteti i politikës monetare, në një masë të madhe, varet dhe nga shkalla e zhvillimit, të tregjeve në përgjithësi dhe të atij financiar në veçanti. Duke ju kthyer edhe një herë kontekst

historik, duhet theksuar se trashëgimia e Shqipërisë në këtë drejtim, në fillim të viteve 1990, ishte zero. Po kaq i vërtetë është dhe fakti, se megjithë rrjedhën e viteve përsëri përvoja e grumbulluar dhe transformimet që sistemi financiar ka pësuar kanë qenë të pakta. Aktualisht, sistemi financiar mund të karakterizohet si një bashkësi e sistemit bankar me një rrjet shoqërisht sigurimesh si dhe me praninë e disa shoqërive të tjera financiare relativisht të vogla (kryesisht institute kreditimi).

Siç mund ta dini dhe ju vetë, sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 13 banka tregtare prej të cilave vetëm njëra është me pronësi shtetërore, por që, sipas të dhënave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2001 zë rreth 62 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar. (Për më shumë hollësi shih tabelën 3. Sistemi bankar në Shqipëri.) Ky dominim është i pranishëm në të gjitha segmentet⁶⁷ e tregut financiar, dhe më konkretisht ai është shumë i dukshëm në tregun e parasë, në tregun ndërbankar, në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë etj..

Sistemi i sigurimeve duket se dalëngadalë po merr formë. Në momentin aktual, në tregun e sigurimeve veprojnë 4 shoqëri, të gjitha me kapital shqiptar, por megjithatë ashtu si në rastin e Bankës së Kursimeve edhe në tregun e sigurimeve kemi praninë e një operatori shumë të madh shtetëror, INSIG-ut.

Nuk është arritur të bëhet ende progresi i duhur në krijimin e një tregu të rregulluar dhe fleksibël të fondeve private të pensionit. Funkcionon vetëm Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili subvencionohet nga buxheti i shtetit. Nuk është ende e qartë nëse ekziston ndonjë projekt, i cili do të krijonte stimujt e duhur për krijimin e këtij sistemi pensionesh mbi koncepte tregu, dhe duket se edhe për disa kohë ky treg do t'i mungojë Shqipërisë.

⁶⁷ Pavarësisht kësaj, duhet theksuar se këto tregje lënë për të dëshiruar si kur i referohemi numrit ashtu edhe volumit të transaksioneve.

Tabelë 3. Sistemi Bankar në Shqipëri.

	T1-00	T2-00	T3-00	T4-00	T1-01	T2-01
Pesha e bankave në totalin e aktiveve						
Banka e Kursimeve	64.4	63.6	61.0	64.8	63.3	61.6
Banka Kombetare Tregtare	13.7	13.1	12.7	9.4	9.4	9.7
Banka Italo Shqiptare	5.8	5.9	6.0	5.4	5.4	5.3
Banka Arabe Shqiptare Islamike	1.0	1.0	0.9	0.8	0.8	0.8
Banka Dardania	1.1	0.8	0.8	0.7	0.7	0.6
Banka Tirana	3.8	4.1	5.1	5.1	5.5	5.9
Banka Kombetare Greke	2.5	2.6	2.6	2.6	2.6	2.6
Banka tregtare Nderkombetare	0.5	0.6	0.5	0.6	0.6	0.7
Banka Alpha	2.1	2.3	2.9	3.0	3.1	3.3
Banka Amerikane e Shqiperise	3.1	3.5	4.6	4.3	5.1	5.6
Banka Fefad	1.1	1.4	1.6	1.7	1.9	2.0
Banka e Parë e Investimeve	0.5	0.6	0.7	0.8	0.9	1.1
Banka Ndertregtare	0.4	0.5	0.6	0.7	0.7	0.9
Pesha e bankave në totalin e depozitave të pranuar						
Banka e Kursimeve	71.5	71.3	69.1	69.3	67.6	66.0
Banka Kombetare Tregtare	10.4	9.9	9.8	9.7	9.6	10.1
Banka Italo Shqiptare	4.8	4.7	4.6	4.2	4.3	4.4
Banka Arabe Shqiptare Islamike	0.5	0.4	0.3	0.3	0.3	0.3
Banka Dardania	1.0	0.7	0.7	0.6	0.5	0.4
Banka Tirana	3.2	3.4	4.0	4.1	4.8	5.1
Banka Kombetare Greke	2.3	2.4	2.5	2.5	2.4	2.4
Banka tregtare Nderkombetare	0.3	0.3	0.3	0.4	0.5	0.5
Banka Alpha	1.7	1.8	2.2	2.4	2.4	2.6
Banka Amerikane e Shqiperise	3.1	3.7	4.8	4.6	5.5	5.9
Banka Fefad	1.0	1.2	1.4	1.5	1.7	1.9
Banka e Pare e Investimeve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Banka Ndertregtare	0.1	0.1	0.2	0.3	0.3	0.5
Pesha e bankave në totalin e kredive të dhëna						
Banka e Kursimeve	21.8	20.3	18.2	43.1	41.9	37.2
Banka Kombetare Tregtare	41.4	39.6	36.5	0.0	0.0	0.0
Banka Italo Shqiptare	18.5	20.2	21.8	25.8	25.6	25.0
Banka Arabe Shqiptare Islamike	0.0	0.0	0.1	0.0	0.2	0.2
Banka Dardania	0.0	-0.1	-0.1	0.6	0.6	0.6
Banka Tirana	6.4	6.4	7.3	8.9	9.5	10.5
Banka Kombetare Greke	0.1	0.2	0.5	0.6	0.7	0.7
Banka tregtare Nderkombetare	2.2	2.0	1.9	2.0	2.0	1.8
Banka Alpha	2.7	2.7	4.0	6.3	7.1	7.7
Banka Amerikane e Shqiperise	2.4	3.1	4.2	5.3	5.3	6.2
Banka Fefad	4.6	5.5	5.5	7.1	6.9	6.8
Banka e Parë e Investimeve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Banka Ndertregtare	0.0	0.1	0.1	0.3	0.3	3.3

Një kategori vitale e sistemit financiar në vendet e zhvilluara janë pa dyshim ndërmjetësit dhe ndihmësit financiarë. Fatkeqësisht, kjo kategori i mungon, pothuajse totalisht, ekonomisë sonë dhe me sa duket, ashtu sikurse ndodh rëndom dhe në ekonomitë e huaja, zhvillimi i tyre do të vijë natyrshëm me aktivizimin e tregut të kapitaleve, të letrave me vlerë, të derivativëve etj..

Ky skarsitet i madh institucionesh financiare si dhe një gjendje ende jo e konsoliduar e njësive prodhuese, ka bërë që dhe rrallësia e instrumenteve financiare të jetë po kaq e madhe. Risia e parë daton me vitin 1995, kur u lançua një instrument i ri për financimin e deficitit buxhetor, bono e thesarit. Që nga ajo kohë e deri më sot zhvillimet në këtë drejtim kanë qenë të pakta dhe kryesisht konsistojnë në disa instrumente të reja afatshkurtra, si marrëveshjet e riblerjes, të cilat aktualisht po përdoren nga Banka e Shqipërisë për të siguruar kontrollin monetar në ekonomi.

Aktualisht mungojnë instrumente të tilla si: kambiale, obligacione, letra tregtare, çertifikata depozitash të tregtueshme, dëftesa dhe obligacione qeveritare, kontrata *options* dhe *forward*, derivatet, garancitë, angazhimet, hua për kreditkartat, kredi për hipoteka, qira financiare, kredi tregtare, kredi për blerjen e letrave me vlerë, kredi nga investimet e huaja direkte për filialet e tyre në Shqipëri etj.. Edhe kur tek-tuk, në ndonjë bilanc kontabël hasen zëra të tillë si “aksione dhe kapitale të tjera” ato përfaqësojnë raste të rralla, duke mos treguar një prirje të përgjithshme.

Megjithatë, edhe pse duket se mungon plotësisht si ajo kategori agjentësh ekonomikë, që normalisht rregullojnë dhe manipulojnë rrjedhën e fondeve të lira dhe të kursimeve në një ekonomi ashtu dhe instrumentet me të cilat ata operojnë, vlerësohet se përsëri ekonomia shqiptare, edhe pse në mënyrë të rrezikshme, arrin ta realizojë këtë proces. Duket se megjithë progresin e bërë, përsëri një volum i madh transaksionesh, korente dhe kapitale, kryhet në rrugë joformale, duke mbajtur të lartë shkallën e pjesëmarrjes së tregut joformal të ekonomisë në totalin e transaksioneve që ekonomia jonë kryen në njësinë e dhënë të kohës.

Duke mos u ndalur më tej në analizën e tregjeve, në “lojtarët” që luajnë në to si dhe në rregullat me të cilat ata pranojnë të luajnë, do të nënvizoja një fakt tjetër shumë të rëndësishëm, pamundësinë e politikës monetare për të qenë efektive në një ambient të tillë, si ai i përshkruar më sipër.

Kështu, mjafton të përmendim se zgjedhja e bërë në vitin 1992, për zbatimin e masave administrative, ishte totalisht e kushtëzuar nga gjendja e atrofizuar e tregjeve në atë moment. Po kështu edhe në krizën e vitit 1997, politika monetare u sfumua nga përqindjet e tregut të fajdesë, ndërkohë që në momentet aktuale, si rezultat i disa zhvillimeve pozitive në tregun e parasë, Banka e Shqipërisë po mundohet ta mbajë politikën⁶⁸ e saj vetëm me instrumente tregu. Shpjegimet e dhëna më sipër si për parakushtet që duhet të plotësohen ashtu dhe për domosdoshmërinë e pranisë së një tregu të zhvilluar, do të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë aspekte të veçanta, shkaqet dhe zgjedhjet e imponuara të politikës monetare në rrjedhën e dhjetëvjeçarit të kaluar.

OBJEKTIVI FINAL I POLITIKËS MONETARE


Që nga korriku 1992 e deri në ditët tona për asnjë moment nuk është vënë në diskutim se përparësia e të gjitha përparësive qëndron në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Duke ju kthyer dhe një herë debatit të madh se mbi çfarë objektivash duhet të shënjojë politika monetare, Banka e Shqipërisë zgjodhi kontrollin dhe stabilitetin e çmimeve duke konsideruar se të gjithë objektivat e tjerë të politikës monetare janë në funksion të objektivit kryesor.

Në asnjë rast nuk ka ndodhur që objektivi final i politikës monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë të ketë qenë një objektivi tjetër i ndryshëm nga ai i cituar më sipër, edhe pse shpeshherë, sidomos në vitet e para (periudha 1992 – 1994) në disa nga raportet e Bankës së Shqipërisë thuhet se objektivat e politikës monetare të Bankës janë stabiliteti i çmimeve, rritja e prodhimit dhe arritja e ekuilibrit të jashtëm të ekonomisë. Megjithatë, në ndryshim nga vitet e para, në këto dy vitet e fundit Banka e Shqipërisë ka bërë një hap përpara (pa dyshim një hap i guximshëm) kur që në fillim të vitit 1999, filloi të shpallë publikisht vlerën sasiore të objektivit final të politikës monetare. Më konkretisht, një interval objektiv për normën e inflacionit në fund të vitit, i matur si ndryshim i thjeshtë vit më vit.

E njëjta gjë ka ndodhur dhe për vitin aktual⁶⁹ 2001, vit për të cilin Banka e Shqipërisë ka vendosur si objektivi final të politikës së saj mbajtjen e inflacionit vjetor, në fund të vitit, brenda intervalit 2 – 4 për qind.

⁶⁸ Më poshtë do t'i kthehemi përsëri këtij argumenti kur të evidentohet mekanizmi i transmissimit të politikës monetare në Shqipëri.

⁶⁹ Është i dyti vit rradhazi.



Grafiku 5. Realizimi i objektivit të Inflacionit

(Fundi i periudhës; Ndryshim V/V)

Gjithësesi, duhet pranuar se në rrjedhën e viteve të tranzicionit, shifrat e faktuara të inflacionit kanë qenë të ndryshme nga ato të vendosura objektivi, fillimisht me zhvendosje të mëdha prej tij e më vonë gjithnjë e në kufij më të ngushtë. Pavarësisht, duhet theksuar se me përjashtim të dy viteve, atij 1996 dhe 2000, në të gjitha rastet e tjera inflacioni i faktuar ka qenë poshtë shifrës objektivi. Ndoshta për herë të parë, viti 2001 do të regjistrojë një përputhje⁷⁰ midis inflacionit dhe objektivit të vendosur për të (Shih grafikun 5. Realizimi i objektivit të inflacionit.)

REGJIMI I POLITIKËS MONETARE

Në përcaktimin e regjimit të politikës monetare, duket se Banka e Shqipërisë, para së gjithash, është kushtëzuar nga ambienti ekonomik dhe nga natyra e mekanizmit të transmisionit që karakterizonte ekonominë tonë në fillimin e viteve '90. Megjithatë, duhet theksuar se ky regjim ka mbetur i pandryshuar gjatë gjithë hapësirës kohore që kemi marrë në shqyrtim, pavarësisht se me kalimin e kohës ka pasur zhvillime të reja.

⁷⁰ Kjo do të thotë një faktim i inflacionit vjetor brenda intervalit objektivi nga 2 – 4 për qind.

Megjithëse, Bankës së Shqipërisë, që në ligjin e parë të saj të vitit 1992, i është njohur e drejta për të ideuar dhe për të zbatuar politikën valutore të vendit, rrethanat e momentit i jepnin përparësi përzgjedhjes së një regjimi të pastër monetar, ku si objektiv i ndërmjetëm që nga ajo kohë e deri në ditët tona vazhdon të jetë agregati monetar M3 ose siç quhet ndryshe oferta e parasë.

Kjo përzgjedhje midis dy alternativave, parasë dhe kursit të këmbimit, në favor të së parës, para së gjithash është kushtëzuar nga pamundësia për të mbështetur një regjim të fiksuar të kursit të këmbimit. Edhe pse rezultati i dëshiruar do të ishte më i shpejtë në rastin e adoptimit të një regjimi fiks të kursit të këmbimit (për më shumë zbatim të këtij regjimi është më i lehtë), në kohën për të cilën flasim niveli i rezervave valutore në dispozicion të Bankës së Shqipërisë ishte shumë i ulët dhe, për më tepër, deficitin në bilancin e pagesave ishte i thellë dhe rritej nga njëra periudhë në tjetrën.

Edhe pse në atë kohë ishte e vështirë të parashikoheshin shumë probleme që mund të lindnin, mund të konkludoj se zgjedhja e bërë dhe qëndrimi në të, gjatë gjithë periudhës në fjalë, ka qenë një zgjidhje optimale. Këtu, kam parasysh se shumë vende në zhvillim si dhe në tranzicion kanë në grackën e paaftësisë së daljes nga regjimi i kursit të këmbimit. Siç thotë z. Crockett⁷¹ “Për aq kohë sa regjimi i kursit të këmbimit është duke funksionuar, politikëbërësit nuk gjejnë arsye për ta zëvendësuar atë. Dhe në momentin që monedha e tyre gjendet nën goditje, autoritetet nuk dëshirojnë të besojnë se strategjia e fiksimit të monedhës tashmë është e dështuar”.

Pavarësisht kësaj, duhet pohuar se edhe adoptimi i parasë si një ancorë nominale, ka kufizimet e veta, që në njëfarë mënyre janë shfaqur dhe në rastin e Shqipërisë, sidomos këto vitet e fundit. Më konkretisht, dua të evidentoj se megjithë analizat e pakta empirike, lidhja e parasë me inflacionin nuk rezulton e rëndësishme, një arsye kjo e fortë për të konsideruar dhe qëndrimin e mëtejshëm në të.

Duke ju kthyer zhvillimeve në ofertën e parasë duhet theksuar se objektiv i për agregatin monetar M3, ka reflektuar zhvillimet e konstatuara në inflacion, në prodhim, në politikën fiskale, në sektorin e jashtëm etj.. Megjithatë, edhe në këtë rast, ashtu si në rastin e inflacionit shifrat e faktuara kanë pasur devijime nga

⁷¹ Andrew Crockett, “Monetary policy objectives in light of Asian crises”, Monetary Policy Frameworks in a Global Context, faqe 224.

objektivi, por që në të shumtën e rasteve kanë qenë sipër tij (Shih grafikun 6. Realizimi i objektivit për paranë gjithsej.)

KUFIZIMET SASIORE NË KRAHUN E AKTIVEVE

Për aq kohë sa autoritetet shqiptare janë të gatshme dhe pranojnë të nënshkruajnë marrrëveshje mbështetjeje me FMN-në, ato janë të detyruara që të respektojnë disa kufizime sasiore, të cilat kryesisht synojnë vendosjen nën kontroll të aktiveve të brendshme të sistemit bankar dhe të aktiveve, në përgjithësi të bankës qendrore.

Në këtë mënyrë, këto kufizime marrin natyrën e një objekti sasior monetar të ngjashëm për nga natyra me objektivin e ndërmjetëm për paranë gjithsej.

Siç e kemi përmendur dhe më sipër, Shqipëria, programin e parë me FMN-në e ka nënshkruar që në gjysmën e dytë të vitit 1992, dhe, që në atë kohë, për herë të parë, u zbatuan kufizime sasiore të cilat më konkretisht synonin në vendosjen e niveleve kufi të sipërm dhe të poshtëm, për gjendjen e treguesve të tillë si: mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë (kufi i poshtëm), për mjetet e brendshme neto të sistemit bankar (kufi i sipërm) i ndarë në kredi neto për qeverinë dhe kredi për ekonominë.

Të ashtuquajturat kritere të arritjes së suksesit vazhdojnë të përdoren dhe sot ndonëse diçka më ndryshe nga vitet e para të tranzicionit. Pa u zgjatur në detaje teknike të mënyrës së përcaktimit të nivelit të këtyre objektivave, do të dëshiroja të sqaroja shkurtimisht arsyen dhe logjikën, që qëndron prapa këtyre objektivave.


Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë, të cilat njihen edhe si rezerva ndërkombëtare neto e saj, kanë lidhje me zhvillimet e bilancit të page-save dhe reflektojnë qëndrueshmërinë e pozicionit valutor të një vendi.

Këto rezerva janë garanci për të mbrojtur kursin e këmbimit të lekut, në rastet kur, si pasojë e lëvizjeve të dëmshme afatshkurtra apo spekulative të tij, Banka e Shqipërisë e shikon të nevojshme një ndërhyrje të saj në tregjet valutore.


Rezervat valutore shikohen, gjithashtu, edhe si mundësia e fundit në financimin e shpenzimeve apo të konsumit të një ekonomie, në raste zhvillimesh të paparashikuara; për këtë arsye ato maten edhe në muaj importesh dhe objektivi i tyre mbështetet edhe në këtë logjikë. Kredia e sistemit bankar për qeverinë shërben si një tjetër masë për disiplinimin dhe kontrollin e shpenzimeve buxhetore.

Banka e Shqipërisë angazhohet të kontrollojë nivelin e kreditimit të sistemit bankar për qeverinë duke ndihmuar në kontrollin e nivelit të borxhit të brendshëm publik dhe, indirekt, shpenzimet qeveritare që kanë pasoja inflacioniste për ekonominë.

Duke qenë se ky objektivi përfshin në vetvete rolin dhe kontributin e tre aktorëve, Ministri-së së Financave, bankave tregtare dhe Bankës së Shqipërisë, kontrolli ynë mbi të nuk është i plotë; por ai ushtrohet duke u mbështetur në instrumentet indirekte të politikës monetare.



Grafiku 6. Realizimi i objektivit të Parasë Gjithsej
(Fundi i periudhës; Ndryshim V/V)



Grafiku 7. Shmangia e objektivave ndaj faktit

Mjetet e brendshme neto te Bankës së Shqipërisë pasqyrojnë një pjesë të likuiditetit të gjeneruar nga Banka e Shqipërisë në sistem. Ndryshimet në mjetet e brendshme neto vijnë kryesisht si pasojë e marrëdhënieve të Bankës së Shqipërisë me bankat tregtare dhe me qeverinë. Niveli i këtij likuiditeti përcakton në një masë të madhe gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në ekonomi duke ndikuar edhe nivelin e inflacionit.

Grafiku 7. pasqyron shkallën e realizimit të këtij objekti në periudhën mars 1998 – qershor 2001, periudhë gjatë së cilës Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje mbështetjeje me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

INSTRUMENTET OPERACIONALE

Aktualisht, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka hyrë në një fazë të re interesante të zhvillimit të saj, që nga momenti (tremujori i tretë i vitit 2000, shih figurën 1.) kur u hoq dorë në mënyrë përfundimtare nga aplikimi i instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar. Për një kohë relativisht të gjatë, rreth 8 vjet, zbatimi i politikës monetare ju besua dy instrumenteve kryesore, të cilat në vetvete ishin thjesht dy vendime administrative të Bankës së Shqipërisë të cilat konsistonin në rritjen e kufizuar të tepricës së kredisë nga ana e bankave tregtare si dhe në detyrimin që kishin bankat me kapital shtetëror për të respektuar nivelin minimal të normës së interesit për depozitat me afat në lekë të shpallur nga ana e Bankës së Shqipërisë.

KUFIRI I KREDISË

Sistemi bankar i pazhvilluar dhe mosprania e një tregu formal të zhvilluar të kredisë, i imponuan Bankës së Shqipërisë, domosdoshmërinë, që duke filluar nga mesi i vitit 1992, të kontrollonte sasinë e kredisë të dhënë sektorit joqeveritar, nëpërmjet aplikimit të kufijve të kreditit në mënyrë të veçantë për çdo bankë të sistemit bankar. Për të siguruar një lloj fleksibiliteti si dhe për të inkurajuar bankat që të fillonin forma të thjeshta të transaksioneve ndërbankare, u pa e arsyeshme që kufijtë të ishin të tregtueshëm.

Gjithësesi duhet thënë se problemet e hasura ishin të shumta, sidomos ato që kishin të bënin me raportimin dhe me mbikëqyrjen e respektimit të kufijve të akorduar. Kredia e re për sektorin privat⁷² filloi të rritet me ritme të shpejta, dhe në fund të vitit 1993, ajo zinte rreth 11 për qind të totalit të kredisë krahasuar me 4 për qind që ishte një vit më parë. Për shumë arsye objektive dhe subjektive, respektimi i këtyre kufijve, në shumë raste, u bë i pamundur, duke ulur eficiencën e këtij instrumenti.

Megjithatë, shtimi i huamarrjes në sektorin informal të ekonomisë, uli gradualisht kërkesën për kredi ndaj sistemit bankar, ndërkohë që, duke filluar nga muaji maj 1995, sistemit bankar ju shtua dhe një alternativë tjetër investimi, bonot e thesarit. Në këtë mënyrë, roli i kufirit të kredisë ra ndjeshëm dhe sidomos pas krizës së vitit 1997, kur si për shkaqe të normave të mbikëqyrjes bankare ashtu dhe për arsye të skepticizmit që karakterizon sistemin bankar ndaj

⁷² Ndonëse duhet thënë që baza e nisjes ishte shumë e ulët.

biznesit privat në përgjithësi, ky instrument filloi të humbasë kuptimin e tij derisa në vitin 1999, u hoq dorë përfundimisht nga aplikimi i mëtejshëm i tij.

PËRQINDJA E INTERESIT

Në kontekstin historik, përpara vitit 1992, përqindja e interesit nuk ka luajtur ndonjë rol shpërndarjeje në ekonomi. Gjatë gjithë viteve '80, përqindja e interesit për depozitat ishte e pandryshuar në intervalin 0.5 – 3 për qind, ndërkohë që, nuk ekzistonte diferencimi midis përqindjeve të kredisë me depozitat. Edhe pse në nëntor të vitit 1991, pati një rritje të përgjithshme të përqindjeve të interesit, përsëri ato nuk mundën të ishin “konkurruese” me normat e një inflacioni galopant që po kalonte ekonomia në atë periudhë.

Me fillimin e përpjekjeve për stabilizimin e ekonomisë, në mesin e vitit 1992, akordimi i një përqindjeje reale në kthim u mendua se do të ishte kyçi kryesor në arritjen e suksesit, sidomos për mobilizimin e burimeve dhe të investimeve financiare. Lëvizja e parë ishte rritja e përqindjes minimum për depozitat me afat në lekë, nga nivele të ulta në 4 – 8 për qind në 22⁷³ – 32⁷⁴ për qind. Në përgjigje të kësaj të fundit edhe normat për përqindjet e kredisë u rritën ndjeshëm, duke arritur kulmin me 39 për qind për kreditë me maturim njëvjeçar.

Efekti i kësaj rritjeje, në dy tre vitet e para të tranzicionit ishte i qartë dhe i dukshëm. Frenimi i hemoragjisë së parasë, përkoi me një rritje të depozitave në sistem, ndërkohë që inflacioni u frenua ndjeshëm duke zbritur në mënyrë konstante deri sa ariti në një nivel njëshifror, në fundin e vitit 1995.

Pa qenë nevoja t'i kthehemi edhe një herë fenomenit fajde, periudha 1996 – 1997, ndoshta dhe diçka me herët, përkon me një kolaps total të përqindjes së interesit dhe, për rrjedhim, dhe të vetë politikës monetare të asaj kohe, derisa vijmë në një periudhë tjetër rritjeje të madhe të përqindjes administrative të interesit për depozitat me afat në lekë.

Zhvillimet e faktura në inflacion, gjatë periudhës 1999 – 2000, ishin të pazakonta, pasojë e tyre ishte një zbutje e vazhdueshme e kushteve të politikës monetare përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në këtë mënyrë vimë në tremujorin e tretë të vitit 2000, kur reagimi i

⁷³ Përqindja për depozitat me maturim tremujor.

⁷⁴ Përqindja për depozitat me maturim dymbëdhjetëmujor.

bankave nuk po ndiqte më uljet e vazhdueshme të përqindjes administrative, nga ana e Bankës së Shqipërisë. Në këto rrethana u mor në konsideratë, një rikonceptim i tërë kuadrit operacional të deriatëhershëm, dhe u vendos që politika monetare e Bankës së Shqipërisë të bazohej vetëm në zbatimin e instrumenteve të tregut. Më konkretisht, u vendos që roli i përqindjes bazë në ekonomi t'i jepej, normës së përqindjeve të marrëveshjes së riblerjes (repove), transaksione këto që do të zhvilloheshin në ankande të rregullta javore⁷⁵ të cilat do të mbaheshin nga ana e Bankës së Shqipërisë. Siç e tregon dhe figura 1., instrument parësor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është norma fikse e përqindjeve të repos, e cila në varësi të sinjalit që do të çojë në treg Banka e Shqipërisë, ofrohet ose në ankande ku shuma e pranuar është e pakufizuar⁷⁶ kundrejt çmimit të fiksuar, ose në ankande ku shuma e pranuar është fikse⁷⁷ dhe çmimi i shpallur është nivel kufi. Pavarësisht formës së ankandit qëllim i vetëm është kontrolli i likuiditetit në sistem, duke synuar mbajtjen e tij në nivele optimale, në mënyrë që të sigurohet eficiencë maksimale e mekanizmit të transmisionit.

Nga ana tjetër, siç mund të meret me mend, përqindja fikse e repove, shërben dhe si referencë për përqindjet e tjera, kryesisht e kam fjalën për lehtësirat kredituese që Banka e Shqipërisë i ofron sistemit bankar.

⁷⁵ Në varësi të synimeve të Bankës së Shqipërisë, ankandet mund të jenë: (i) marrëveshje riblerjeje – për të thithur likuiditet – ose marrëveshje të anasjellta riblerjeje – për të injektuar likuiditet në treg.

⁷⁶ Në këtë rast mund të thuhet se i tregut i jepet sinjali i një politike monetare neutrale, ashtu siç po ndodh aktualisht që prej pranverës së fundit.

⁷⁷ Fillimisht ankandet e repove konsistojnë në pranimin e shumave të shpallura që më parë kundrejt një çmimi tavan gjithashtu, të shpallur. Me anë të këtij veprimi, tregut i jepet një sinjal i qartë për të ulur më tej përqindjet e interesit.




Figura 1. Korniza aktuale e politikës monetare

INSTRUMENTE TË TJERA

Përdorimi i instrumenteve të tërthorta të kontrollit monetar, megjithë zhvillimet e kohëve të fundit, duhet theksuar se është më i hershëm, dhe për këtë do të kujtoj aplikimin e rezervave të detyrueshme, ofrimin e një numri lehtësirash kreditimi nga ana e Bankës së Shqipërisë etj.. Megjithatë, duhet theksuar se vitet e fundit kanë shënuar lëvizje të mëdha në drejtim të kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë dhe, më konkretisht, do të evidentoja shkurtimisht listën, statusin, qëllimin, etj. të instrumenteve monetare aktualisht në dispozicion të Bankës së Shqipërisë.

SHITBLERJET ME TË DREJTA TË PLOTA TË LETRAVE ME VLERË

Shitblerjet permanente të letrave me vlerë mund të përdoren në ato raste kur kërkohet një sterilizim, me bazë të qëndrueshme, i tregut. Aktualisht, si instrumenti që përdoret në kryerjen e këtyre transaksioneve shërbejnë bonot e thesarit me maturim deri në një vit si dhe me afat maturimi të mbetur, jo më pak se 14 ditë. Gjatë vitit 2001, janë kryer dy shitje permanente bonosh thesari për një shumë prej rreth 8 miliardë lekësh dhe në të dyja rastet, blerësi ka qenë Banka e Kursimeve.

NDËRHYRJET NË TREGUN VALUTOR

Megjithëse Banka e Shqipërisë ka adoptuar një regjim këmbimi valutor plotësisht fleksibël, ajo përsëri gjatë gjithë kohës ka qenë e pranishme në treg sigurisht në shumicën e rasteve për të shmangur spekulimet me Lekun. Në rastin e shtiblerjes së valutës transaksionet mund të jenë me të drejta të plota ose me bazë të përkohshme (*swaps*).

LEHTËSIRAT KREDITUESE

Kredia Lombard.

Lehtësia e kreditimit Lombard është prezantuar relativisht herët, por duhet thënë se ajo është përdorur në raste shumë të rralla⁷⁸. Kuptohet që qëllimi i saj është klasik, ofron një ndihmë për bankat me probleme të përkohshme⁷⁹ likuiditeti dhe konsiderohet si burim kreditimi i fundit, pasi të jenë shfrytëzuar paraprakisht të gjitha mundësitë e tjera. Aktualisht, përbën dhe përqindjen më të shtrenjtë që ofron Banka e Shqipërisë në sistem.

Çmimi i kredisë Lombard⁸⁰, caktohet si shumë e përqindjes së repove plus një penalizim në masën 6 për qind.

Kredi njëditore.

Kjo lehtësi kreditimi i është ofruar sistemit bankar vitin e fundit, dhe ka për qëllim furnizimin me likuiditet njëditor të bankave të veçanta, që kanë nevojë për të. Nga vetë emri kuptohet që kredia duhet shlyer ditën pasardhëse dhe çmimi⁸¹ i saj, ashtu si kredia Lombard, bazohet në çmimin e repove plus një penallti në masën 2.5 për qind. Kredia⁸² njëditore është përdorur rrallë.

Rezervat e Detyrueshme.

Rezerva e detyrueshme është një nga instrumentet e pakta të kontrollit të tërthortë, që është përdorur që nga korriku i vitit 1992, dhe që për më tepër ka ruajtur të njëjtin nivel prej 10 për qind.

⁷⁸ Në periudhën 2000 – 2001 nuk është përdorur asnjëherë.

⁷⁹ Maturimi i saj shkon deri në tre muaj dhe mund të përfitohet vetëm një herë gjatë një tremujori.

⁸⁰ Aktualisht, çmimi i saj është 13 për qind.

⁸¹ Aktualisht çmimi i saj është 9.5 për qind.

⁸² Deri më 31 tetor 2001.

Rezerva e detyrueshme llogaritet mbi të gjitha depozitat⁸³ (detyrime të bankave tregtare ndaj të tretëve) si në lekë ashtu dhe në monedhë të huaj. Një risi e kohëve të fundit, i përket tetorit të vitit 2000, kur Banka e Shqipërisë, me qëllimin e vetëm për të ulur koston e ndërmjetësimit të sistemit bankar, ofroi një nivel remunerimi të tyre fillimisht në masën 1/3 e përqindjeve⁸⁴ të tregut dhe duke filluar që nga tremujori i parë i vitit 2001, e nxitur nga dëshira për të pasur një efekt më të shpejtë, niveli i remunerimit kaloi nga 1/3 në 1/2 e përqindjeve të tregut.

PAQARTËSI DHE EFICIENCË E ULËT E MEKANIZMIT TË TRANSMISIONIT MONETAR

Për shumë arsye të përmendura dhe më sipër, mekanizmi i transmisionit në Shqipëri, është i ndryshëm nga ai, që mund të jetë tipik për një ekonomi të vogël tregu të hapur. Aktualisht, mendimi i specialistëve, përfshirë dhe atë të ekspertëve të FMN-së ka konverguar drejt konkluzionit se efekti i politikës monetare zbehet ndjeshëm nga prania e disa faktorëve si: (i) pozicioni monopol i Bankës së Kursimeve në tregun e depozitave në lekë; (ii) roli i kufizuar i kreditimit në lekë; (iii) diferenca relativisht e madhe midis përqindjeve të interesit për kredinë me ato për depozitat; (iv) aktiviteti i kufizuar i tregut ndërbankar, i cili është i përqendruar në instrumente shumë afatshkurtra; (v) të ardhurat nga emigrantët; (vi) zotërimet e mëdha në *cash* në lekë dhe në valutë të huaj të individëve shqiptarë etj..

Siç mund të merret me mend, figura 2 pasqyron një version të mundshëm⁸⁵ të transmetimit të vendimeve të politikës monetare në ekonomi dhe akoma më shumë, rolin e indikatorëve dhe të politikave të tjera makroekonomike mbi inflacionin.

Parë nga ky këndvështrim, me të drejtë mund të shtrohet pyetja: A do të jetë përqindja e repove e aftë të përçojë vendimet e Bankës së Shqipërisë në ekonomi? Nga figura duket se, momentalisht, përqindja e repos ndikon përqindjen e depozitave dhe atë të kredive ndërkohë që ka një rol më të zbehtë mbi kursin nominal të

⁸³ Bëjnë përjashtim depozitat ndërbankare.

⁸⁴ 1/3 e përqindjes së bonove të thesarit me maturim tremujor për rezervën në Lekë dhe 1/3 e përqindjes së depozitave mujore në usd dhe në euro respektivisht për rezervën në usd dhe për rezervën në euro.

⁸⁵ Deri në momentin aktual pranohet si përjashtim më e besueshme. Për vetë faktin se ekzistojnë ende paqartësi në lidhje me një sërë ndikimesh të politikës monetare mbi variabla apo mbi tregjet, në përgjithësi, në figurë janë paraqitur dy lloj linjash. Ato të ndërprera me ngjyrë të kuqe pasqyrojnë lidhje ende të paargumentuara mirë, ndërkohë që linjat e plota me ngjyrë jeshile pasqyrojnë kanale transmetimi eficiente.

këmbimit. Nga ana tjetër, sipas diagramës⁸⁶, vihet re se është politika fiskale, kursi nominal i këmbimit, transfertat nga emigrantët etj., të cilat kanë një ndikim më të plotë mbi kërkesën agregate, e për rrjedhim mbi inflacionin.

Bazuar në diagramëm e mësipërme, në bashkëpunim dhe me specialistët e FMN-së, është përvijuar deri-diku dhe forma e një modeli⁸⁷ të vogël makroekonomik, i cili në vetvete është një bashkësi ekuacionesh që tentojnë të kapin, në një nivel shumë të agreguar, lidhjet më kryesore. Përkryerja e këtij modeli, në të ardhmen afatshkurtër, konsiderohet si një prioritet i punës në Bankë, pasi zotërimi i një modeli të tillë është në përputhje dhe me objektivin afatmesëm të Bankës së Shqipërisë, për një adoptim të mundshëm të regjimit *inflation targeting*.




Figura 2. Korniza aktuale e politikës monetare

⁸⁶ Diagrama, përveç të tjerash edhe një herë nxjerr në pah, domosdoshmërinë e përqendrimit të vëmendjes në zhvillimin me përparësi të tregut financiar në vend. Tregje të tilla si ai i kapitaleve, i letrave me vlerë, i aktivieve fikse, etj., janë kanale potenciale dhe me rëndësi jetike në përcimin e vendimeve të politikës monetare në ekonomi.

⁸⁷ Për hollësiira të mëtejshme mund të kontaktoni me personelin e Departamentit të Kërkimeve, Sektori i Ekonomisë.

E ARDHMJA: INFLATION TARGETING APO ...

Shpjegimet e dhëna më sipër si dhe vetë logjika e kësaj konference, natyrshëm shtrojnë një pyetje të rëndësishme: Cili është vizioni i Bankës së Shqipërisë për të ardhmen sidomos për atë pak më të largët? A mendohet se politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vazhdojë të marrë jetë në këtë kornizë që kemi sot, ku, siç u pa dhe më lart, paqartësitë që e karakterizojnë atë janë të shumta, apo do të tentohet që efekti i saj mbi ekonominë të jetë më i plotë dhe pse jo plotësisht i matshëm?

Në përgjigje të këtyre dilemave, do të theksoja se aktualisht Banka e Shqipërisë e ka marrë një vendim, i cili, para së gjithash kupton adoptimin e një regjimi të politikës monetare, në qendër të së cilës do të jetë përsëri stabiliteti i çmimeve të konsumit. Por, në ndryshim nga sa tani edhe vetë objektivi i ndërmjetëm i saj do të jetë po i njëjti variabël makroekonomik: Inflacioni. Besoj se e kuptoni që bëhet fjalë për atë regjim të politikës monetare, që këto kohët e fundit ka gjetur një shtrirje gjithnjë e më të madhe e që, për shkak të vështirësive në gjetjen e një shprehjeje të saktë dhe koncize në shqip, do ta thërras njësoj si në gjuhën e tij *Inflation Targeting Regime* (IT).

Aktualisht, mund të thuhet se IT është një strategji e suksesshme kur ai, nga njëra anë gjen një terren të shëndoshë makroekonomik dhe institucional dhe, nga ana tjetër, vihet përballë një auditori (agjentët ekonomikë, individët, publiku në përgjithësi) i cili e kupton dhe e mirëpret atë.

Duke u ndalur në secilin nga aspektet e sipërpërmendura do të fillonim me:

Aspekti Makroekonomik.

Inflacioni.

Në përgjithësi, literatura rekomandon se një periudhë 2–3 vjeçare me inflacion⁸⁸ të ulët duhet t'i paraprijë adoptimit të regjimit të *targeting inflation*. Normë e ulët konsiderohet një normë inflacioni që luhatet nga 1- 3 për qind. Në tërësi, gjatë viteve të fundit, tendenca ka qenë ulja e normës së inflacionit dhe për gati një vit,

⁸⁸ Megjithatë, shtete të tilla si Republika Çeke, Polonia, e ndonjë tjetër e kanë adoptuar këtë regjim në kushtet e pranisë së një norme inflacioni në intervalin 6 – 10 për qind.

që nga dhjetori i vitit të kaluar, inflacioni është luhatur shumë pranë kufirit të sipërm të intervalit të objektivit.

Megjithatë, në vite të ndryshme ka qenë i pranishëm faktori *shock*, si për norma të larta inflacioni ashtu dhe për norma të ulëta. Mesatarisht, norma vjetore e inflacionit për periudhën janar 1993 – shtator 2001 ka qenë 24.6 për qind, ndërkohë që vetëm për katër vitet e fundit janar 1998 – shtator 2001 ka qenë 6.5 për qind. Po të hedhim një shikim më të hollësishëm në secilin nga vitet e periudhës së fundit, në mënyrë respektive për vitet 1998, 1999, 2000 dhe 2001 do të kishim 21.6 për qind, 0.4 për qind, 0.0 për qind dhe 3.3 për qind.

Për rrjedhim, mbështetur në ecurinë e deritanishme të inflacionit, edhe pse viti aktual ka shenja të një rritjeje të tij në krahasim me dy vitet e mëparshme, gjykohet se ekzistojnë premisat që të aplikohet një regjim IT. Duhet theksuar se ecuria e inflacionit në periudhën 1999 – 2000 është pasqyrim i shumë goditjeve *shock*, të cilat kanë ndikuar në ecurinë e pazakontë të tij.

Kursi i këmbimit.

Regjimi i kursit të këmbimit është një ndër pikat e tjera të forta në adoptimin e IT. Në rastin e vendit tonë është fat, që Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimet, që zgjedhin dhe administrojnë llojin e politikës valutore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Për më tepër, që nga viti 1992, Banka e Shqipërisë ka zgjedhur një regjim këmbimesh valutore lirisht të luhatshtëm, ku si tipar kryesor është përcaktimi i çmimit të monedhës në bazë të kërkesë-ofertës. Aplikimi i këtij regjimi është një nga kriteret, që kërkon aplikimi i targetimit të inflacionit, e, për rrjedhim, mund të themi se edhe ky tregues përbën një pikë të fortë mbështetjeje, për fillimin e zbatimit të regjimit IT. Kjo sidomos po t'i referohemi stabilitetit të monedhës sonë, Lekut, si në raport me dollarin amerikan ashtu dhe me monedhën europiane, Euron. Për të katërtin vit radhazi Leku ka qëndruar stabël, duke e detyruar Bankën e Shqipërisë që më së shumti të qëndrojë në pozicionin e “një spektatori të thjeshtë” të zhvillimeve në tregun valutor.

Konsolidimi fiskal.

Vitet e fundit kanë shënuar hapa të rëndësishëm edhe në drejtim të konsolidimit fiskal. Është fakt se gjatë viteve të fundit, buxheti i shtetit pati “fatin” të përfitojë të ardhura të konsiderueshme në

valutë (në formën e ndihmave dhe të të ardhurave për privatizimin). Këto të ardhura, kanë zbutur ndjeshëm presionin e politikës fiskale mbi atë monetare, e për rrjedhim, sistemi bankar nuk është vënë përpara vështirësish për likuiditete, ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka respektuar limitet që përcakton ligji në financimin e deficitit buxhetor.

Megjithatë, nuk mund të flitet ende për konsolidim dhe stabilitet të plotë fiskal. Për këtë gjykim, nisemi nga struktura e të ardhurave të buxhetit (pjesë të konsiderueshme kanë ende të ardhurat nga doganat), evazionit fiskal dhe praktikat disi arbitrare në grumbullimin e tatimeve dhe në aplikimin e çmimeve të referencës. Nga ana tjetër, autoriteti fiskal nuk ka adoptuar shkallën e duhur të transparencës. Kjo do të thotë që efektiviteti i përdorimit të të ardhurave buxhetore nuk është plotësisht i qartë. Së fundi, niveli i ulët i mirëqënies në Shqipëri (renditet vendi i katërt më i varfër në Europë), papunësia e lartë si dhe praktikat jo të mira në administrimin e të ardhurave buxhetore janë faktorë, që do të ushtrjnë presion të fortë mbi autoritetet për ekspansion buxhetor dhe për dobësim të pozicionit dhe të stabilitetit fiskal. Parë nga ky këndvështrim, duke ditur dhe vështirësitë në veçimin e asaj pjese të inflacionit, që shkaktohet nga politika buxhetore, mund të thuhet se për aq kohë sa tregu i bonove do të jetë i vetmi treg letrash me vlerë në Shqipëri, për aq kohë sa nuk do të ndalohej me ligj huamarrja e qeverisë nga Banka e Shqipërisë, për aq kohë sa nuk do të ketë një angazhim të plotë dhe të besueshëm nga të gjitha forcat politike për një administrim rigoroz dhe transparent të të ardhurave fiskale etj., është i vështirë aplikimi i sukseshëm i regjimit IT.

Stabiliteti financiar.

Nëse nisemi nga krizat e sistemit financiar, Shqipëria nuk ka kaluar të tilla. Kjo qëndron për atë pjesë të ekonomisë, e cila ndryshe quhet dhe ekonomi formale. Në Shqipëri, *de facto*, me gjithë krijimin e tre instituteve të reja të sigurimit, sistemi financiar mund të identifikohet me atë bankar. Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se kriza e vitit 1997, megjithëse nuk u shkaktua nga sistemi bankar, përsëri kishte në bazë një fenomen tipik financiar, pasojat e të cilës ishin të pallogaritshme mbi treguesit kryesorë makroekonomikë, prodhim, inflacion, papunësi, bilanc pagesash etj..

Nga sa më sipër, mund të ngrihet pyetja: cili është sistemi imunitar i Shqipërisë ndaj krizave financiare?

Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, që janë bërë në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes bankare, ende sistemi bankar është i pazhvilluar dhe ofron shkallë të ulët ndërmjetësimi. Ai paraqitet shumë i përqendruar dhe operon në kushtet e ekzistencës së një niveli të lartë të rrezikut (i gjithë spektri që nga ai politik e deri tek ai operacional) kuadri rregullativ nuk është i plotë dhe ka difekte në zbatimin e rregullave etj..

Nga ana tjetër, tregjet dhe institucionet e tjera financiare janë akoma në nivele foshnjore dhe shkalla e ekspozimit është e lartë. Ekonomia informale vazhdon të jetë e pranishme dhe, me gjithë eksperiencën e hidhur, përsëri ka të dhëna se vazhdon huamarrja ndonëse me përmasa më të vogla.

Siç vihet re, sistemi mbrojtës i Shqipërisë ndaj krizave financiare ka probleme të shumta, të cilat edhe pse njihen prej kohësh nuk po arrijnë të eliminohen. Ky imunizim i dobët, bën që ekonomia shqiptare të ketë shkallë të lartë ekspozimi, e, për rrjedhim, një kusht shumë i rëndësishëm i regjimit IT mbetet pa u plotësuar.

Aspekti Institucional.

Ndërkohë që në aspektin makroekonomik ekzistojnë faktorë, që të shtyjnë të zgjedhësh regjimin IT si regjim të politikës monetare, në aspektin institucional gjykohet se më tepër peshë kanë pikat e dobëta të tij.

Pavarësia e bankës qendrore.

Ligji ofron një pozicion të pavarur, por, në realitet pavarësia e bankës është larg asaj ligjore dhe nën kërcënim. Autoritetet e tjera nuk duket të kenë prirje për të respektuar pavarësinë e bankës qendrore. Nga ana tjetër, nuk ka garanci të mjaftueshme se pavarësia e shprehur në ligjin ekzistues (tërësisht apo elemente të veçanta të saj) nuk do të jetë subjekt i ndryshimeve të mëvonshme.

Transparenca e bankës qendrore.

Gjithashtu, vlerësohet se transparenta e Bankës së Shqipërisë është ende larg standardeve. Ajo nuk është ende transparente në thelbin e saj: shpjegimin e procesit vendimmarrës, sidomos për çështje të politikës monetare.

Besueshmëria e bankës qendrore.

Nuk mund të thuhet se Banka e Shqipërisë ka fituar besueshmëri në publik. Duhet kuptuar se publiku shqiptar, në fillim ka patur nevojë të dijë se ekziston një bankë qendrore që quhet Banka e Shqipërisë. Nga ana tjetër, adoptimi i regjimit IT në kushtet kur në Shqipëri është e lartë mundësia e devijimit nga objektivi, pasi inflacioni ndikohet mjaft nga faktorët *shock*, sigurimi i kredibilitetit do të jetë i vështirë.

Përgjegjshmëria e bankës qendrore.

Në realitet, vlerësohet se përgjegjshmëria duhet rritur. Banka e Shqipërisë është angazhuar në respektimin e të gjitha detyrimeve për raportim, por cilësia e këtij raportimi është subjekt përmirësimi gjë, që pritet të rrisë përgjegjshmërinë reale të saj.

Marrëdhëniet jo të mira me autoritetin fiskal.

Niveli i koordinimit midis autoritetit monetar dhe fiskal nuk është në nivelin që kërkon regjimi IT. Në praktikë, kjo mungesë koordinimi pengon Bankën e Shqipërisë në zbatimin me efikasitet të instrumenteve për arritjen e politikës monetare.

Pra, në tërësi, aspekti institucional konsiderohet si një pikë e dobët për adoptimin e regjimit *targeting inflation*.

Shkalla e Kuptimit nga Publiku.

Leksionet e para praktike mbi atë se çfarë është inflacioni, shqiptarët i morën në fillim të viteve '90. Me kalimin e viteve, pak a shumë, kushdo e kuptoi se rritja e çmimeve gërryen të ardhurat dhe kursimet e tyre, por shumë pak e kuptojnë se misioni i vështirë i mbajtjes së tyre stabil i përket një institucioni, që quhet Banka e Shqipërisë. Në fakt, shqiptarët kuptuan një gjë që "për të gëzuar nesër, sot duhet të shtrëngojmë rripin". Një apel i bërë nga të dyja forcat kryesore politike në kohën e ardhjes së tyre në pushtet. Pavarësisht kësaj, ata nuk arritën të kuptojnë mekanizmin që të çon nga e sotmja e shkatërruar në një të ardhme më të pasur dhe më të sigurtë dhe kjo përforcohet më shumë dhe nga zgjatja e pambarimtë e periudhës tranzitore dhe e dështimeve të shumta gjatë saj (kryesisht për arsye subjektive). Një numër i kufizuar njerëzish, janë të aftë të shpjegojnë se pse nevojiten reforma të thella, ndërkohë që një pjesë tjetër gjendet në pozitat e të

zhgënjyerit dhe shumica me indiferencën e saj i pranon ato siç i jepen.

Në këtë prizëm është e vështirë të besohet se Banka e Shqipërisë do të gjejë "partnerë" të denjë në krahun tjetër për të kuptuar dhe interpretuar drejt vendimet e saj. Në rastin kur publiku kupton dhe e mirëpret politikën e bankës qendrore, ai vetë me pritjet e tij për inflacionin (të orientuara nga objektivi i vënë për inflacionin) shndërrohet në një lloj faktori për përcaktimin e inflacionit të së ardhmes.

Në fakt, ndërgjegjësimi i publikut, familjarizimi i tij me politikën, bankë etj., përmirësimi i kuadrit institucional në përgjithësi, është një detyrë e momentit, e cila nuk ka nevojë për të pritur për kompletimin e kushteve të tjera paraprake. Disa nga rrugët ku duhet punuar, do të identifikoheshin si më poshtë:

1. Angazhimi për rritjen e transparencës së Bankës së Shqipërisë. Për këtë qëllim, ky institucion ka shtuar numrin e publikimeve, sidomos të publikimeve shpjeguese, paraqitjen në media, kontaktet me publikun, organizimin e takimeve e seminareve, ka miratuar strategjinë dhe një rregullore për transparencën.
2. Angazhimi për përmirësimin e marrëdhënieve me institucionet e tjera shtetërore. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë, ka adoptuar një qëndrim më intensiv në të gjithë organizmat ndërinstitucionalë (integrimi në EU, Pakti i Stabilitetit, diskutimin e dokumenteve si strategjia e zhvillimit të *SME*-eve). Më e spikatur është veprimtaria në kuadrin e komitetit të borxhit.
3. Angazhimi për rritjen e përgjegjshmërisë. Banka ka shtuar kontaktet dhe raportimet në Kuvend duke u munduar të rrisë nivelin e shpjegimit për vendimet e marra.
4. Angazhimi për rritjen e kredibilitetit. Përveç realizimit të objektivave dhe të shpalljes së këtij fakti, Banka e Shqipërisë po përpiqet të fitojë publikun dhe të vendosë komunikim të rregullt me të. Banka po organizon fushata (për kreditimin); po afrohet me biznesin për të kuptuar pritshmëritë e tij etj..
5. Angazhimi për të realizuar edukimin. Edukimi përfshin vetë Bankën e Shqipërisë, autoritetet e tjera dhe publikun. Për këtë, Banka ka ofruar dhe mbështetjen financiare.
6. Angazhimi në rritjen e pavarësisë së bankës qendrore.
7. Angazhimi në çështje të tjera, që nuk janë drejtpërdrejt detyrë e Bankës së Shqipërisë, por që ndikojnë në krijimin e parakushteve për adoptimin e IT. Si të tillë përmendim angazhimin në projektet për përmirësimin e statistikave.

Mbi këtë bazë, Banka e Shqipërisë ka mundësi të realizojë ndërtimin e modeleve për analizimin dhe për parashikimin e inflacionit dhe të përsosjes së mekanizmit të transmisionit.

Plotësimi i secilit prej kushteve të mësipërme ose përmirësimi i tyre, kërkon një periudhë kohe 2–3 vjeçare, ndoshta dhe më shumë. Ky interval kohe, para së gjithash, përcaktohet bazuar në paqartësinë e Bankës së Shqipërisë mbi angazhimin e autoriteteve të tjera për këtë regjim, mbi reagimin e publikut; në nevojën për ndërtimin e një modeli makroekonomik (përfshirë dhe një periudhë testimi); në rritjen e eficiencës së tregut financiar, në zgjerimin e tij nëpërmjet thithjes së aktiviteteve joformale, në forcimin e mbikëqyrjes bankare, etj.; në përsosjen e mëtejshme të tregut të parasë në mënyrë që të zotërohet një instrument efikas kontrolli mbi paranë etj..